



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI

Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal

Mbledhja nr.57/2019

Prishtinë, më 29.1.2019, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Hykmete Bajrami, Lutfi Zharku, Muharrem Nitaj dhe Veton Berisha, anëtarë.

Munguan: Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Glauk Konjufca, Liburn Aliu, Memli Krasniqi dhe Duda Balje, anëtarë.

Pjesëmarrës: Vatra Qehaja, LVV; Dren Ajeti, Klubi i prodhuesve; Leart Jusufi, KDI; Doruntina Kastrati, BIRN dhe Mira Avdimetaj, Arbresh.info.

Stafi mbështetës i komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Nurie Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Planit të punës së komisionit për vitin 2019;
3. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Planit të punës së komisionit për vitin 2019

Kryetarja theksoi se bazuar në programin legjislativ të Qeverisë dhe në fushëveprimin e komisionit, sipas procedurave, jemi të obliguar të hartojmë planin e punës së komisionit për vitin 2019. Është hartuar një draft, ku është paraparë shqyrtimi i projektligjeve, shqyrtimi i raporteve të agjencive të pavarura, monitorimi i zbatimit të ligjeve, vizita bizneseve, vizita institucioneve të pavarura dhe ndërmarrjeve publike, raportim të ministrave, si dhe çështje tjera. Plani është fleksibil dhe aktivitetet mund të zhvendosen më herët apo më vonë. Ajo propozoi që vizitat bizneseve private, të fillojnë më herët nga muaji prill dhe të vizitohen segmente të caktuara të bizneseve. Monitorimin e zbatimit të ligjeve e kemi paraparë në plan, por nuk e kemi caktuar se cilin ligj, në mënyrë që të vendosim së bashku. Në takim me OJQ “Demokracia plus”, ata kanë shprehur gatishmërinë për të mbështetur komisionin në monitorimin e ligjeve.

Hykmete Bajrami, theksoi se varësisht cilin projektligj jemi duke e shqyrtuar edhe vizitat të përqendrohen të ato biznese që ndërlidhen me atë projektligj. Ajo potencoi se duhet t'i vizitohet edhe bizneset të cilat përfitojnë grante dhe subvencione nga shteti. Ajo, po ashtu, theksoi se duhet të jemi të hapur me asociacionet e bizneseve dhe gjatë shqyrtimit të çdo projektligji të japim mundësinë për dhënien e propozimeve të tyre.

Dardan Sejdiu, tha se me miratimin e projektligjeve për tregtinë e brendshme dhe tregtinë me jashtë, të planifikuara për këtë vit, do të kompletohet pakoja e legjislacionit tregtar. Në programin legjislativ të Qeverisë, Projektligji për tregtinë e brendshme dhe tregtinë me jashtë, janë planifikuar në distanca të mëdha kohore mes vete. Njëri në shkurt e tjetri në shtator. Në fillim të shkurtit, të planifikojmë një vizitë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë dhe të marrim informacionet e duhura. Ai shtoi se gjatë shqyrtimit të këtyre projektligjeve të mbahen dëgjime publike, po ashtu tha se do të bëjë mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit, që ka mbetur nga viti i kaluar, të cilin grup pune edhe e udhëheq.

Veton Berisha, tha se raportimi i ministrave është planifikuar në fund të vitit dhe pyeti: a mund t'i ftojme edhe në kohë tjera për çështje të caktuara?

Kryetarja sqaroi se ministrat mund të ftohen për raportim, kurdo që ne si komision shprehim interes për ndonjë çështje. Sa i përket qasjes së bizneseve, ne si komision jemi të hapur dhe po ashtu edhe në ueb faqen e Kuvendit publikohet çdo hap i shqyrtimit të projektligjit në Kuvend. Dëgjimet publike, edhe në të kaluarën, i kemi mbajtur gjatë shqyrtimeve të projektligjeve dhe do të vazhdohet edhe për projektligjet që do të shqyrtohen këtë vit.

Pas propozimeve, komisioni nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Plani i punës së komisionit për vitin 2019.

3. Të ndryshme Çështjet vijuese

a) Shkresa e kompanisë “Shqikos-Aralco” Sh.A. (Fabrika e ujit “Kika”)

Kryetarja theksoi se ka ardhur një shkresë nga fabrika e ujit “Kika”, e cila paraqet problemet e saj me qasjen në rrjetin e energjisë elektrike. Unë i kam takuar edhe në zyrën time dhe mendoj që duhet ta trajtojmë si komision problemin e këtij biznesi dhe problemeve të ngjashme, sepse edhe më herët ka pasur probleme të kësaj natyre të bizneset tjera. Pala është ankuar në ZRRE dhe i kanë thënë se sipas ligjit pala duhet t’i bëjë investimet vetë. Kemi kërkuar prej ZRRE-së përgjigje, lidhur me problemet e kompanisë dhe ZRRE-ja na ka dërguar vendimin e bordit të ZRRE-së për këtë çështje. Ne duhet të shohim nëse ligji është pengesë për bizneset.

Muharrem Nitaj, theksoi se ende nuk e kam marrë këtë informacion dhe kërkoj që të njoftohet.

Hykmete Bajrami, theksoi se kjo kompani e ka problemin me KEDS-in. KEDS-i kërkon që investimi i rrjetit nga fabrika e ujit “Kika”. Përveç, që kërkohet nga fabrika të bëjë investimin në rrjet, por edhe investimi i kalon si aset KEDS-it, edhe pse KEDS-i nuk ka investuar. Mirëpo, për këtë duhet të kontaktojmë ministrin e Zhvillimit Ekonomik, sepse kjo ministri është përgjegjëse për zbatimin e kontratës me KEDS-in.

Dardan Sejdiu kërkoj që fillimisht ta kemi materialin, që ta shqyrtojmë këtë çështje.

Pas diskutimeve, komisioni nxori këtë:

Konkluzion

T’u shpërndahet të gjithë anëtarëve të komisionit materiali i dërguar nga kompania “Shqikos-Aralco” Sh.A. , si dhe përgjigja e ZRRE-së dhe më pas do të vendoset për hapat e mëtejshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Sala BERISHA SHALA